



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 2047 datë 31.12.2021

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E DËMTUARA PIKËSORE, PËR 59 BANESA INDIVIDUALE, BASHKIA KAMËZ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 89, datë 28.05.2021, pika 33 “Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njërive individuale të banimit, të vlerësuara “për shembje” referuar Akt Ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit, sipas kërkesës me nr. 4110 prot., datë 19.04.2021 të Bashkisë Kamëz, për rindërtimin e 65 (gjashtëdhjetë e pesë) njërive individuale të banimit, në zbatim të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.146, datë 07.23.2020, Nr.150, datë 07.12.2020 dhe Nr.169, datë 23.12.2020 dhe nr. 22 datë 19.02.2021 dhe listës bashkëlidhur”

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 59 banesa Individuale, Bashkia Kamëz, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
  - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
  - b) Materiali hartografik:
    - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
    - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës.
  - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.

2. Miratohet rindërtimi në Zonat e Dëmtuara Pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponentës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 59 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore për 59 banesa Individuale, të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI**

**RAKIP SULLI**

